



Breaking News:

Durrës/Vihen në pranga 2 shtetas të akuzuar për vjedhje



13/07/2023

# Fier – Finalizohet Operacioni Policor I Koduar “Finalizimi”

Fier/Mbante armë zjarri me vete, teksa lëvizte me automjet, si rezultat i administrimit të menjëhershëm të inteligjencës policore, arrestohet në flagrancë 26-vjeçari.

Gjatë operacionit policor të koduar “Finalizimi”, sekuestrohen një pistoletë, municion luftarak dhe një automjet.

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Fier, si rezultat i kontrolleve të pandërprera në të gjithë territorin e qarkut, për të garantuar rendin dhe sigurinë publike, si dhe për të nxjerrë përpara përgjegjësisë penale, shtetasit që posedojnë sende të kundërligjshme, kanë organizuar operacionin policor të koduar “Finalizimi”, si rezultat i të cilit u kap në flagrancë dhe u arrestua shtetasi E. S., 26 vjeç, banues në Fier.

Gjatë kontrollit në automjetin që drejtonte 26-vjeçari, iu gjet një çantë brenda së cilës ishte një armë zjarri pistoletë dhe municion luftarak, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale, së bashku me këtë automjet.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, për veprime të mëtejshme.

Kërko

Enter a word for search

Q

Komisariati Dixhital

GET IT ON

Google Play

Download on the App Store

Arkiva

Select Month

- Linqe
- >

Arkiva
- >

Akademia e Sigurisë
- >

Ministria e Brendshme
- >

Agjencia e Mbikëqyrjes Policore
- >

Interpol
- >

Europol
- >

Misioni PAMECA V
- >

SCPA
- >

Projekti Trivalent

◀ Raporti ditor i ngjarjeve, 13 korrik 2023

Drejtori i Drejtorisë Hetimore Antimafia të Italisë, vizitë në Policinë e Shtetit, për të konsoliduar urat e bashkëpunimit kundër krimit të organizuar ▶